

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 59/2014 “PËR KARRIERËN USHTARAKE NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj ka për qëllim përmirësimin e ligjit nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, duke plotësuar disa mangësi që janë evidentuar ndër vite, gjatë zbatimit të tij.

Ndryshimet e propozuara në ligjin nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, synojnë të mundësojnë përfshirjen e sportistëve elitare në radhët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe krijimin e një strukture ku ata do të angazhohen/vendosen. Këto ndryshime i shërbejnë njohjes së kontributit të sportistëve në promovimin dhe lartësimin e emrit të vendit tonë në arenën ndërkombëtare përmes performancës së tyre, si dhe në përmirësimin e mënyrës së menaxhimit të karrierës së ushtarakëve aktivë në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTAVE TË TJERA POLITIKE

Projektligji nuk është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2022.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, synon:

- a) përcaktimin e qartë të termit “sportist i nivelit të lartë”;
- b) shtimin në spektrin e gradave për ushtarakët dhe të gradës honorifike. Në kushtet kur sportistët e nivelit të lartë nuk janë ushtarakë aktivë të rekrutuar sipas kriterëve të përcaktuara në ligj, iu jepet mundësia për të përfituar gradën honorifike me përfitime të njëjta financiare si mbajtësit e gradave aktive, në përputhje me performancën e tyre sportive;
- c) njësimin e titullit/renditjes në garë (lojëra olimpike, kampionat botëror/evropian/mesdhetar) me gradën përkatëse. Hierarkia sportive do të njësohet ose

përafrohet me hierarkinë e gradave honorifike që sportistët e nivelit të lartë do të mbajnë. Gradat e propozuara janë “major” deri “kolonel”;

- c) përparimi në gradë në rastet kur sportisti i nivelit të lartë performon më mirë se grada që mund të kenë marrë më parë. Në rast se sportisti i nivelit të lartë në momentin që merr gradë fillestare “major” ose “nënkolonel”, në përputhje me performancën e tij, në momentin që performon më lartë se më parë, gëzon të drejtën e gradës në përputhje me nivelin e ri të performimit. Sportisti gëzon të drejtën e mbajtjes së gradës për performancën më të lartë;
- d) përjashtimin e gradës honorifike e për rrjedhojë të mbajtësve të saj, nga detyrimet që burojnë nga ligje të tjera që normojnë e rregullojnë veprimtarinë e ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, është në përputhje me Kushtetutën dhe në harmoni plotë me legjislacionin në fuqi.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNITAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përmban në total 6 nene.

Neni 1 i projektligjit parashikon që në nenin 5 shtohen përkufizimet përkatëse për sportistin e nivelit të lartë dhe gradën honorifike.

“Sportistë të nivelit të lartë” ka të njëjtin kuptim sipas përcaktimeve të ligjit nr. 79, datë 24.06.2017 “Për sportin”, i ndryshuar.

“Gradë honorifike” është grada, e ndryshme nga gradat ushtarake të listuara në nenin 12 të këtij ligji, e cila i jepet sportistit të nivelit të lartë.”

Neni 2 i projektligjit parashikon që në nenin 12 bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:

a) Në pikën 1, germa “ç”, togfjalëshi “Lloji i gradës “Ushtar I”, bëhet “Lloji i gradës “Kadet”;

b) Pas pikës 4, shtohet pika 5, me përmbajtje:

“5. “Grada “Kadet” për efekt të pagesës njësohet me gradën “Ushtar I”.

Në nenin 3 të projektligjit:

- Shtohet neni 12/1, i cili parashikon gradat honorifike.

“Neni 12/1
Grada honorifike

1. Sportistit të nivelit të lartë i jepet grada honorifike me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, me propozim të shefit të Shtabit të Përgjithshëm.
 2. Propozimi për dhënien e gradës honorifike bëhet nga një komision i posaçëm me përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes dhe një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për sportin.
 3. Grada honorifike njësohet me gradën e ushtarakut aktiv vetëm për efekt trajtimi me pagë.
 4. Sportisti i nivelit të lartë mban gradën honorifike, sipas përcaktimeve të nenit 14 të këtij ligji.
 5. Grada honorifike i jepet sportistëve të cilët kanë arritur një nga rezultatet e përcaktuara në nenin 12/2 të këtij ligji dhe praktikojnë sport profesionist, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 79, datë 24.06.2017 “Për sportin”, i ndryshuar.
 6. Pas shkëputjes nga sporti profesionist, sportistit të nivelit të lartë i ndërpritet marrëdhënia financiare me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, me propozim të shefit të Shtabit të Përgjithshëm.
 7. Në rastet kur sportisti i nivelit të lartë, mbajtës i njëres prej gradave honorifike arrin një rezultat më të lartë, sipas të cilit merret një gradë honorifike më e lartë, me propozim të shefit të Shtabit të Përgjithshëm, me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, i jepet grada honorifike më e lartë.”
- Shtohet neni 12/2, i cili bën klasifikimin e gradave honorifike sipas rezultateve si sportist i nivelit të lartë.

“Neni 12/2
Klasifikimi i gradave honorifike

Gradat honorifike, sipas rezultateve si sportist i nivelit të lartë janë:

Rezultati	Grada
a) Sportisti, i cili thyen rekord olimpik/botëror/evropian	Kolonel
b) Vendi i parë deri në vendin e tretë në Lojërat Olimpike/kampionat botëror	Kolonel
c) Vendi i parë në kampionatin evropian	Kolonel
ç) Vendi i dytë deri në vendin e tretë në kampionatin evropian	Nënkolonel
d) Vendi i katërt deri në vendin e gjashtë në Lojërat Olimpike	Nënkolonel
dh) Vendi i shtatë deri në vendin e tetë në Lojërat Olimpike	Major
e) Vendi i katërt deri në vendin e gjashtë në kampionate botërore	Major

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

- Shtohet neni 12/3, i cili parashikon se:

“Neni 12/3

Ministria e Mbrojtjes mbështet iniciativat për krijimin dhe funksionimin e shoqatave sportive në Forcat e Armatosura. Krijimi, organizimi dhe regjistrimi i tyre, bëhet sipas legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse.”

Në nenin 4 të projektligjit bëhet ky ndryshim:

Në nenin 26, pika 1, shkronja “b”, fjalët “kryerjen e një krimi me dashje zëvendësohen me fjalët “një krim të kryer me dashje apo vepër penale të kryer me pakujdesi, e cila cenon figurën dhe integritetin e Forcave të Armatosura”.

Në nenin 5 të projektligjit bëhen ndryshime në pikën 2, të nenit 27. Pas togfjalëshit “Gjatë kësaj periudhe...” shtohen fjalët “...dhe deri në emërimin në detyrë...”

Neni 6 parashikon hyrjen në fuqi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Mbrojtjes.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIUBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga grupi i punës, ngritur me urdhrin nr. 1586, datë 19.10.2021, të ministrit të Mbrojtjes.

Ky projektligj është dërguar për mendim në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe në Ministrinë e Drejtësisë.

Ministria e Arsimit dhe Sportit ka shprehur dakordësi me draftin e ripunuar.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet sistemit e-akte kanë kthyer përgjigje me komente dhe sugjerime. Këto komente dhe sugjerime janë reflektuar në projektligj dhe relacion.

Gjithashtu, projektligji është hedhur për konsultim publik në faqen e Ministrisë së Mbrojtjes dhe në faqen zyrtare të Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENjKP).

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMET BUXHETORE

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Projektligji i propozuar nuk paraqet efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit, sepse kostoja buxhetore e projektligjit, konkretisht shpenzimet e personelit për paga dhe kontribute sigurimesh, si dhe efekti financiar është llogaritur për numrin maksimal të ushtarakëve në Tabelën e Organizimit dhe Pajisjeve (TOP). Numri i përfituesve vlerësohet të jetë i limituar (i vogël), për rrjedhojë janë brenda limiteve buxhetore dhe efektet financiare shtesë për sportistët elitarë janë të përfshira në llogaritjen për buxhetin e shtetit.

Përlllogaritjen e kostos së detajuar financiare e gjeni bashkëlidhur relacionit shpjegues.

PROPOZUESI

MINISTRI I MBROJTJES

Niko Peleshi

Konceptoi: Nëntoger E. Myrtaj
Miratoi: A. Çollaku
Konfirmoi: G. Prodani
1k/ datë: 31.10.2022